jeshilta: i vinë gëzime të reja. E hipura mbi dru të madh: sheh fuqi edhe lajme të mira. Cili bje nga druri: bje nga nderi. Kush ha dru: helmohet. Kush mbledh dru shërohet. Kush sheh fletra: pajoset me veshje.

* * *

Kush sheh inxhi mëson kur-an e dituri, po të shohë gruaja inxhi a merxhan: mbetet e randë; buleziku nderim edhe gas. E mvarura në dorë byzelik të florintë: miras Jakuti: niqah e damas. Buleziku i ergjëntë: shënon mall edhe pjesë, po për beqarët del martesë. Mashkulli po të shohë bulezik: bën hajrat edhe evlat. Po të shohish të vdekurin me bulezik: është në xhennet. Gjerdhan' i florintë: del fat. Unaz e florishtë: evlat. Vëthi: tregëti edhe murat. Kush sheh flori fiton dituri edhe shpëton nga hidhërimet. Kush gjen flori: i vjen argjënt edhe hajir. E humbura ose e tretura, e gëlltitura flori: s'del mirë. Ergjëndi: shënon besë të qëruar edhe mall të kulluar. Bakëri edhe hekuri: fuqi. Kallaji e plumbi: pasuni. Parat e vogla: dalin fjalë. Myhyri, zymryti, mermeri: kallzojnë nderim edhe përparim për jetë.

(ZOT-i me të math të Vet e di më mirë).

### Kur sheh qytet, ndërtesë, dyqan, bamam, mulli, furrë: ëndra ç' kallëzon?

Kush sheh qytet: i mbretëron besimi edhe shëndeti. Shtëpija, pallati: del grua e pasuni, e rënë shtëpija fatkeqësi. E ngrehura shtëpi në një katund ose qytet ose kurbet atje është martesë, në shtëpi e para fytyra me shpirt janë punra jashtë fesë. Dyqani shë-



non mall dhe evlat grua edhe fat të mirë. Furra: martesë edhe gëzim, furra po të shihet në behar s'del fat i mbarë, kush sheh furrën e gëlqerës; gradohet. Kush sheh mulli ose mjell, shtohet me rizk.

* * *

Dritarja: shënon mall, nderim, për të sëmurin shëndet edhe gëzim, për beqarët; martesë edhe trashëgim. Shkallët: përparim; shtylla besim, oxhaku murat, porta rahmet edhe fat, ura dituri edhe drejtësi.

(Zoti i di më mirë).

### Kur sheh pemë, zarzavate, bimëra, ëndra ç' kallëzon?

Pemët po të shihen në kohë: ësht hajr, po pa kohë; s'dalin mirë. E hangura kumlla a mollë të ëmla: del gëzim, molla dhe kumlla e tharrët: hidhërim. Dardha, kajsija, ftoj, hajir, të pa pjekurat: jo mirë, rush i zi: shtëngim, rush i bardhë: zgjërim, rush i përtharë: risk i mbarë, rush i thatë s'del mirë, pjergulla: shënon grua me pasuni. E mbjella llozenka: mbarësi. E hangura fiq: del risk, martesë, evlad. Bajam dhe fletët e bajames: murat; bajam e hidhur: fjal' e drejtë, fëstëku; kollâj mollët, kaçkat dhe lajthitë janë helmë edhe fjalë. Mana: gëzim, thana hidhërim; hurmaja, ulliri, vaji: dalin risk, shëndet edhe fitim.

* * *

Bakllâ jeshil: veshje dhe pasuni, bakllâ e thatë: lirësi. Spanaku: shëndet; ç'do jeshil: bereqet. E han-